

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditësit: nga Mitrovica kundër të paditurës:

të cilën e perfaqëson

, baza e kontestit: Pagesa e të ardhurave personale dhe pagave jubilarë, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 25.06.2013 me datën 16.07.2013 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **REFUZOHET** padia dhe kërkespadia e paditësit nga Mitrovica për Pagesën e të ardhurave personale dhe pagave jubilarë **si e PABAZUAR**.
- **OBLIGOHET** paditësja që në emër të shpenzimeve gjyqësore për aktgjykim të paguajë shumën prej 20 euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së të njëjtit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.


A r s y e t i m

Paditësja, nga Mitrovica, ka ngritë padi për pagesën e të ardhurave personale dhe pagave jubilarë kundër të paditurës / e Arsmit, dhe ka kërkuar nga gjykata që në bazë të kontratës së përgjithëshme kolektive ta obligoj të paditurën që në emër të shpërblimit jubilar dhe pagesës së dy pagave përcjellje në pension të paditëses, e paditura të paguajë dy paga mujore për shpërblim jubilar dhe tri paga mujore për përcjellje në pension, mesatarja e pages mujore per tre muajt e fundit ka qenë në shumë prej 262.22 euro.

Paditësja ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem ne tersi paranë padisë dhe kërkespadis si dhe shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës av. ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka e kontestuar në tërësi padinë dhe kërkespadinë e paditësit për faktin se e njëjta se e njëjta thirret në kontratën kolektive e cila si e tillë ka skaduar nga vlefshmëria, nderkaq në Ligjin për punë këto kompensime nuk janë përcaktuar në mënyer shprehimore, çka duhet të nënkuptohet se këto pagesa mund të kryhen përshtatshmerisht mundësive të institucioneve perkates pa detyrim obligativ.

Me qëllim të vertetimit të plotë të gjendjes faktike dhe vlerësimit të vendimeve të të paditurës gjykata në procedurën e provave administroi këto prova: qarkullimi bankar per paditësen e dt.25.09.2012, kontrata e punës së paditëses nr.02/941/08-09, e dt 03.11.2008(kopje), Vendimi



per pension i dt.02.10.2009, përgjigjeja në kërkes e të paditures drejtuar paditesit e dt.18.09.2012.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto perfundime:

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën e mësimitdhënëse. Po ashtu është jo kontestues fakti se e paditura ka qenë punëdhënësi i fundit i paditëses, me çka vërtetohet edhe me kontratën e fundit të lidhur mes patitësit dhe të paditurës me nr. 0000000000, e dt 03.11.2008

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësja ka parashtruar kërkes drejtuar te paditurës me të cilën ka kërkuar që t'i bëhet pagesa e shperblimit jubilar dhe pagave përcjellse me rastin e pensionimit sipas kontrates kolektive, por e njëjta është refuzuar nga e paditura, si e pa bazuar me arsyetimin se nuk ka mbështetje ligjore për t'u realizuar.

Gjykata me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë, u baza ne faktin sepse kontrata e përgjithshme kolektive, përveç tjerash, ka qenë e lidhur për 3 vite (2005-2008), pra e njëjta nuk është në fuqi. Kështu, edhe me dispozitën e nenit 6.4 të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, është paraparë se "marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje prej jo më shumë se 3 vite", përkatësisht se "marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punonjësit e tyre të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen e tillë kolektive" (neni 6.5 i këtij ligji).

Poashtu, edhe me Ligjin e punës të Republikës të Kosovës (ligji nr.03/L-212-2010) me nenin 90 par.4 dhe 5, parashihet "se marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 vite dhe se ajo vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive.

Sa i përket shpenzimeve procedurale, sipas pikes 2 të dispozitivit u buzau në nenin 452 par 1 të LPK-së, ndërsa lidhur me vendosjen mbi shpenzimet gjyqësore u bazua në nenin 10.12 në lidhje me nenin 10.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Unifikimin e Taksat Gjyqësore nr.2008.

Andaj, gjykata konform nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE
C.nr. 231/2012 me dt. 16.07.2013



UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, që nga dita e pranimit të të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.